

## KANUNI I MATH I SHEN MARISE

*Sherbesa nis me Lutjen Nistore:*

**PRIFTI:** I bekuar eshte Perendia yne, gjithenjë, taní dhe perhere dhe ne jetet e jeteve.

**KORI:** Amín.

**KENDONJESI:** Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*§ here*).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jeteve, Amín.

Trini e Tereshenjte, meshirona; o Zot, hircsoji mekatat tona; o Kryezót fal-i paudhesite tona per emrin tent. Meshiró, o Zot (*§ here*).

Ati yne, qe je ne qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbretaria jote; u-befte deshira jote si ne qell edhe mi dhé; buken tone te perdíçime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtóreve tane; edhe mos na shtjer ne ngasje, po shpetona nga i ligu.

**KORI:** Amín.

*Fas Lutjes Nistore thuhet Psalmi 143:*

## PSALMI 143

Degjoma faljen, o Zot, ver-u veshin lútjeve te mia. Pergjeqmu pas mircsise dhe pas drejtesise sate, dhe mos hyr ne gjyq me sherbetorin tent, se asnjé njerí i gjalle nuke munt te dale i drejte perpara teje. Se armiku ma ndoqi shpirtin; ma shtypi jeten perdhé; me varrosi ne erresire si te vdekur prej kohe. Perandáj me eshte kepu-

tur shpirti, dhe me eshte deshperuar zemra. Kujtónj ditet e lashta, mejtónj gjithë veprat e tua. I ndeh dúarte perpara teje, shpirti im ka etje per ty posi dheu i thate. Pergjeqmu shpejt, o Zot, se m'u-zu fryma; mos e kthe menjane faqen prej meje, se jam bere si atá, qe hidhen ne gropë. Çfaqma meshiren ne mengjës, se me ty kam shprese; tregoma udhen, ku duhet te ecenj, se me ty e kam varrur shpirtin, Çlirome prej armiqve, o Zot, se prane teje vinj te fshihem, mesome te benj deshiren tende, se ti je Perendia im; tregoma udhen e drejtesise, se ti je zemermire. Ngjallme, o Zot, per emrin tent; edhe pas drejtesise sate nxirma shpirtin nga trubullimet; edhe pas meshires sate shtyp-i armiqte e mi; dhe shúaji gjith' atá, qe ma mundojne shpirtin, se une jam sherbetori yt.

*Dhe menjehere thuhet Troparet pasónjese ne T. IV:*

Perendí dhe Zot, permi dhene na u-çfaq, i bekuar esht ay qe vjen me emer in e Zotit (4 here).

Ejani le te rendim prane Hyjlíndeses, dhe te perunjur le t'i biem mcgjúnjazi, dhe me pendím te thelle le t'i thomi me shpirt: Zonje meshirónjese, nermjetó dhe shpetona, eja se u-mbytme krejt, nga mekatat e shuma; mos na largó né besniket e tu, se s' kemi tjater shprese dhe ndíhmese.

LAVDI DHE TANI. Do t'i leçitim kudó o Virgjereshë, çudit e tua né te pavýerit, se po te mos na kishë dale mprójtese, si do te shpetonim valle

prej kaqë rezikesh, dhe kush do na rúante gjer me taní te lire? Prej teje pra s' largóhemi aspák, se besniket po i shpetón gjithenjé nga çdo vrer.

*Pastáj thuhet Psalmi 51:*

### PSALMI 51

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe me shumicen e meshírave te tua shúaji paudhesít' e mia.

Laj-me fare prej paudhesise sime, edhe qerome prej mekatit tim.

Se une i njoh paudhesít' e mia, edhe mekatin tim e kam perpara syve kurdohere.

Kunder teje vetem fejeva, dhe perpara teje e bera te keqen, qe te dalesh i drejte ne fjalet e tua, dhe te jesh i kthiellet ne gjyqet e tu.

Se ja tek u-zura ne paudhesí, dhe ne mekata me lindi nena ime.

Se ja tek deshe te verteten ne zemër, edhe mendjes sime do t' i tregósh urtesí.

Sperkat-me me hysóp, dhe do te qerohem, laj-me, dhe do te behem mé i bardhe se debora.

Bej-me te degjónj gezím dhe ngazellím, qe te me gezohen eshterat e thýera.

Ktheje faqen nga mekatat e mia, edhe shúaji gjithë paudhesít' e mia.

Kthielloma zemren, o Perendí, edhe perseritma frymen e drejte.

Mos me hith tej prej faqes sate, edhe mos ma merr frymen tende te shenjte.

Epma prape gezimin e shpetimit tent, edhe forcome me fryme zoterishte.

Do tu mesónj fajtóreve udhet e tua, edhe te pabeset do te kthehen me ty.

Shpetome prej gjakerash, o Perendí, Perendia i shpetimit tim, gjuha ime do ta lavderonje me gezim drejtesinë tende.

O Zot, çelmi buzet, edhe goja ime do ta leçite lavdine tende.

Se te dëshkeshe therore, do te kisha prure, po hollokostet nuke te pelqejne.

Therore e Perendise eshte fryma e thyer; zemren e thyer dhe te perunjur nuke do ta hedhesh tej, o Perendí.

Bej-i mire Siones pas pelqimit tent; edhe ndertoji muret e Jerusalemit.

Ahere do te pelqesh therore drejtesie, dhurata dhe hollokoste.

Ahere do te bien dema mi altarit tent, edhe meshirome, o Perendí.

*Pastáj thuhet Kanuni ne T. T. IV:*

### ARMATILLATIN FARAO

I. Me ushterite Faraón' e mbyti krejt, nje here brenda ne det, shkop' i Moisiut, i goditur krýqazi, qe i perndau újerat, edhe Israelitet, me kemb' i shpuri ne brek pertéj, dyke lavderuar me ze te math.

Po ma perpjék furtún' e rept' e hélmeve, te mjerin shpirt me rembím, edhe re mjerimesh,

zemren ma helmuan krejt, o Zonje o Hyjlíndese, po ti Nene e Drites, qe zbret prej qellit te jéteve, ndrit-me me shkelqím dhe me ngazellím.

Nga e panúmerta shtrengíc' e hélmeve, dhe prej armiqsh te keqínj, dhe mjerimesh jete, si shpetova i várferi, me forcen tende pa kufí, te hymnónj Virgjereshe, per te památuren simpáthí, edhe ngushellimin per mua pa funt.

Perikenj prane teje se te kam besím, o Zonje o Shen Marí, dhe ne hien tende, rent me tere shpirtin tim, pergjunjem o Hyjlíndese, dhe me vaje te lutem: Mua te mjerin mos me perbúz, o perikje e te Krishtéreve.

Kam per te thirrur gjithenjé me ze te math, per madheshtite qe ke, se pa ty ne krye, Zonje dhe Hyjlíndese, qe gjithenjé po nermjetón, prane Krishtit Perendise, si do te shpetonja i várferi, prej furtúnave dhe rezíkeve.

Shpetona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjunjemi, se ti je fortese qe nuke tundesh.

Shikome ti, me mirésí o Hyjlíndese Virgjereshe, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

III. Kryemjeshter i qellit, o Kryezót krijetar, qe ndertove Kishen e Shenjte, ti me shiguró, se ti na dó dhe na ndih, ti i degjón mekatarët, ti besniket perhér' i mpron, ti njeridáshesi.

Deshperuar se gjithash, po te therrés me vajtím: Eja shpejt ketú dhe perkrah-me, ndih-me

dhe mprojtje nem, mua robít besník, te pocaqisur te mjere, qe shpëtimin po te lyp, me hidherím dhe me lot.

Me ke bërë çudira, Zonje dhe Hyjlíndese, me perkrahe dhe me dhurove, çdo miresí dhe hir, me gas pra te lavderónj, dhe te hymnónj pa pushuar, per keté kujdés nenór, dhe keté dhempsherí.

Po me rreh nje furtune, trubullimesh pa kufí, dhe te reptat vala me mbytnë, Nene Hyjlíndese, pra eja dhe me ndihmó, dhe prej andrállave nxirme, ti o mprójtëse ndíhmese, ti o shpëtimi im.

Virgjereshe dhe Zonje, Nen' e vertét' e Zotit Math, ti e çkaterrove perhere, vdekjen dermónjese, ti perlindje me dhé, se nga greminat e Ferrit, ti me ngjalle perserí, Nene Hyjlíndese.

Shpëtona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortesë qe nuke tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti ma sheró çdo plage te shpirtit.

*Pastáj Prifti kujtón atá, per te cilet behet lutja:*

PRIFTI: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Lútemi edhe per shendetin, per shpëtimin edhe per ndjesen e mekátave te shërbetóreve te Perendise (*aksh*).

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót edhe njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit edhe Birrit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amin.

*Pastáj kendohet:*

#### NDENJESORJA, T. II, TA ANO

Ti je nermjetím, fortesë qe tronditje s' di, burón përdellím, o mprojte e besníkeve, te therresim pra me mall: Virgjereshe Zonje Hyjlíndese, shpëtona nga çdo helm e çdo rezík, se ti je e vétemja perkráhese.

*Pastáj vazhdón Kanuni:*

IV. Ti gjithenjé, ti je per mua fuqí o Zot, ti je drita ti je Perendia im, se pa lenë gjirin aterór, zbrite permi dhene, dhe na shpëtove te vârferit; pra bashke me Profetin, Abakúm te therresim: Forces sate lavdí gjithenjé o Zot.

Ku do te gjenj, gjetke perkrahje Hyjlíndese? Ku te futem? Ku te shkonj dhe te shpëtonj? Cili tjtater me ndihmón si ti, kur me rreh furtuna, dhe jam i mbytur prej válave? Me ty vetem kam shpresë, dhe kuraje dhe mburrje, dhe perikenj me ty o Hyjlíndese.

Lumin e math, t' embel dhe t' arte te hirit tent, qe me vese, e flladiti shpirtin tim, te munduar ne nje Ferr te zi, helmesh dhe mjerimesh, te djegur

si ne nje furre me zjarr, o Nene Virgjereshe, madheshtónj me leçitje, dhe perikenj me ty o Hyjlíndese.

O Shen Marí, o Virgjereshe Hyjlíndese, ty te lutem, mprojtj' e patrondíçime, o perikje streh' e shigurí, arma e shpetimit, kujtome mua te várferin, o shpres' e deshperimit, o sherim i semundjes, o gezím dhe perkrahj' e te mjéreve.

Si t' i tregónj, o Virgjereshe Hyjlíndese, siç po vlejne, perdellimet pa kufí, qe perhere shpirtin tim te zi, keq te poveluar, ma ngjallne si me vesím e fillad? O Zonj' e zemerdhempshur, mirebérese Nene, me gezó me dhuratat e pásura.

Shpetona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortese qe nuke tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos me keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

V. Tej persé me ke hedhur, prej fytyres sate lark, o Drit' e qëllshime? Se me ka mbuluar erre-sír' e zeze te várferin. Kthe-me prane teje, me ndrit me porrosít' e tua, dhe drejtome ner udhet e lúmura.

Te therrés me kendime: Lum' ti o Hyjlíndese, nuse e hýjeshme, streh' e perendishme, lum' ti arm' e keshtjéll' e pakápshime, lum ti ndihm' e mprojtje, lum ti o Zonje shpetimtare, qe me ty po perikim besnikerísht.

Sa m' urrejne po mprehin, majat e shigjétave,

me mihne dhe nje varr, edhe po perpiqen, te ma çjerin te várferin trupin tim, edhe po mundohen, ne dhe te gjalle te me shtien, po prej syresh Hyjlíndese ti me shpetó.

Nga shtrengicat e shuma, helmet e semúndjeve, shpetome Hyjlíndese, dhe me forcen tende te pangár' e shendoshe ti rúaj-me, nga reziket te gjitha, dhe prej armiqve qe me ndjekin, dhe m' urrejne o Zonj' e lavdíshime.

Ç' dhuretí munt te síell, prej nje mirenjóhesi, sipas te mirave, qe me ke dhuruar, dhe híreve te paçemúara? Perandáj me kenge, hymnónj dhe madheshtónj pa prere, simpathín' e pamatur qe ti me çfaq.

Shpetona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortese qe nuke tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

VI. Te fálurit Perendise do tja shtronj, dhe atí do tja tregónj hidherimet, se plot me vrer, shpirti im eshte mbushur, dhe jeta ime ka zbritur perpósh ne Ferr, dhe lutem si Jonáj ne det: Prej gremines me nxir Perendí dhe Zot.

Te zeza re plot me vrer e plot me helm, shpirt e zemer mi mbuluan mi mbytne, jeta m' u-err, o Marí Virgjereshe, po ti qe linde nje Díell qe ndrit ne qell, largoji mjerimet prej nesh, me te lúturat e tua nermjétese.

Ne helm te zi ty te di per ngushellim, edhe ty te njoh per mjek ne semundjet, ti je dermim, i mbaruar i vdekjes, ti je burim i pasosur i jeteve, dhe ti perhere me shpejtim, je perkrahja e gjithe te mjereve.

E çfaq kudó qe meshira s' te ka funt, as burimi i çudive pa numer, dhe me perkráh, pa pushuar te mjerin, dhe dhempsherohesh per mua Hyjlíndese; te gjithëve ua tregónj, dhe therrés dhe leçit gjithënjé per ty.

M' u-mblothne reth hidherimet e jetes, posi mbletet reth qiririt moj Zonje, dhe ploterisht, ma zaptuan krejt zemren, dhe ma plagosin me thumbat e helmeve, po eja ti dhe me ndihmó, dhe i dbo dhe me shpetó o Hyjlíndese.

Shpetome ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjreshë, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortese qe nuke tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjreshë, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

*Prihti pastáj kujtón atá, per te cilet behet lutja:*

PRIFTI: Meshirona, o Perendí, pas meshiresate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Lútemi edhe per shendetin, per shpëtimin edhe per ndjesen e mekátave te sherbetórove te Perendise (*aksh*).

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót edhe njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

*Pas Thirrjes thuhet:*

### SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e te Krishtérove, nermjetare e palodhur e besnikëve, ver-u veshin mekátárove me dhempsherí, se po te therresim beserisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjreshë: Ndhna me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, qe te lusin o Hyjlíndese.

*Pastáj thuhet Shkallesa Kremtore me T. IV:*

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpëtimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Senjte, merr je-te çdo shpirt, dhe lartesohe te paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARGVARK: Do ta kujtónj emrin tent ne gjithe brezat e brézave.

## UNGJILLI PAS LUKAJT

M' até kohë, Jesú j hyri në një katúnt, edhe një grua, e quájtur Martha, e priti në shtepinë e vetë. Dhe ajo kishte një motër, e cila ndenji në kembet e Jesújt, edhe degjonte fjalët e tij. Po Martha sillej rotull, dhe shërbente rëndë, patáj qendrój, edhe tha: "O Zot, vallë nukë të ha malli që ime-motër më ka lënë të shërbënj e vetem? Thúaj-i, të lutem, të më ndihmonjë." Dhe Jesú j u-përgjéq, edhe i tha: "Martha, Martha, po kujdesesh edhe trubullohesh për shumë gjëra, po vetem për një gjë është nevojë; dhe Maria ka zgjedhur pjesën e mirë, e cila nukë do të rëmbëhet prej saj." Edhe kur po i thoshte këtë fjalë, një grua prej pópullit e ngriti zërin, edhe i tha: "Lum' barku, që të ka mbajtur, edhe siset, që ke thëthitur." Po ajo tha: "Jo, po lum' atá, që e degjojnë fjalën e Perëndisë, dhe e rúajnë."

LAVDI, T. II. Atë, Bir edhe Shpirt, një Tríní dhe Perëndí, shúaji paudhësít' e mia.

TANI. Me nërmjetimet e Hyjlíndesës, o meshireplót, shúaji paudhësít' e mia.

*Meshirome, o Perëndí meshireplót, edhe shúaji paudhësít' e mia.*

## T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Mos më neverít taní, pa mprojtje o Virgjërëshë, Zonjë dhe Hyjlíndesë, eja prit-e lutjen e shërbëtorit tënt; helmi më përmbyti krejt, nukë i durónj dot më, shigjetimet e demónëve, strehë gjëkund i s' gjenj, as ku të përikenj i várferi, luftë reth

e rotull kam, tjàter ngushellím gjetke nukë shoh. Zonj' e tërë botes, ti shpres' e mprojtje je për çdo besnik, mos mi përbut pra të lúturat, në meshirë dhe shpëtím.

PRIFTI: Shpëtoje pópullin tënt, o Zot, edhe bekoje trashëgimin tënt; vështroje botën tënde me dhëmpshëri; lartësoje ballën e të Krishtërvë Orthodokse, dhe dërgona meshirat e tua të pásurës. Me nërmjetimet e Shen Marisë, Kryezonjës sonë, Virgjërëshës edhe Nënës së Perëndisë; me fuqinë e Kryqit të çëmuar dhe jeteberës; me mprojtjen e Fórcave qëllorë engjëllorë; të Shen Joán Pëgzorit, Profetit edhe Përërdësit; të Shen Apostujve të lavdëruar dhe emërshkelqyer; të Shen Basilit të Math, të Shen Grigór Theologut edhe të Shen Joán Gojartit, Aterve tanë të Shenjtë, Kryepërfitërvë të mëdhënj dhe Mësónjësve ekumenikë; të Shen Kollit, kryepeshkopit të Mýrave të Likisë, çudibëresit; të Deshmóreve të Shenjtë, të lavdëruar dhe bukurmundes; të Aterve tanë oshënarë dhe hyjprurës; të Shen Joakimit edhe Shen Annes, Hyjprínderve të drejtë; të Shenjtit të Kishes (*aksh*); dhe të gjithë Shenjtóreve; o Zot meshireplót, degjona në mëkataret, që po të lútemi, dhe meshirona.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Me meshirën dhe përdëllimin dhe njeridashjen e Birit të vetëm, më të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin e Tërshenjtë dhe të

mire dhe jeteberes, taní dhe perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

*Pastáj vazhdón gjer ne funt Kanuni:*

VII. Djemat Hebrénj ne mes te furres, me kuraje burrerisht e shkelne flagen, shtine vese ne zjarr, edhe me gas therrisin: Je i bekuar Zot i math, Perendí per gjithë jetet.

Ti qe ke lindur dritemadhin, mua qe jam errur fare nga mekatat, ti me ndrit e me prir, ti qe je en' e drites, o Virgjereshe e ndrícime, qe te lavderónj me kenge.

Ti m' u-bej mprojtje dhe strehe, dhe perkrahje edhe mburrje o Zonje, se s' me mbeti asnjé, pesh-tetje asgjekundi, o forc' e te pandíhmeve, edhe shpres' e deshperimit.

Me tere shpirtin edhe mendjen, po te lavderónj me zemer dhe me buze, se me dhé pasurisht, dhurata pa kursyer, o miresí dhe o çudí, pa kufí edhe pa numer.

Hith-me nje sy te dhempsheruar, dhe shikoji te keqiat qe po vuanj, dhe nga çdo hidherím, nga vojtjet dhe reziket, dhe ngasjet e panúmerta, me shpetó moj Virgjereshe.

Shpetona ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortese qe nukë tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe,

trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

VIII. Zotin e lavderuar dhe te larte, qe mi malin, i çfaqí Moisiut ferren, edhe misterin e Hyjlíndeses Marí, Zotin e hymnoni, dhe e lartsoni perhere dhe per jete.

Virgjereshe Hyjlíndese e dhempshur, ti shikome, se mbytem nga furtún' e keqe, e válave te jetes dhe shpetimin nem, zgjatma doren tende, se jam i keputur nga vojtjet dhe mjerimet.

Shume halle dhe helme dhe nevoja, me bastisne, o Zonj' e Shenjte Virgjereshe, dhe ngasjet me shtrengojne rende nga kudó, eja shpejt dhe ndihme, dhe me nermjetime perkrah-me dhe shpetome.

Te kam gjetur ne shqotat dhe ne helmet, ty limanin, gezimin edhe ngazellimin, dhe ne semundjet mjekun dhe sherónjesin, edhe ne reziket, dhe ne ngasjet mprojtjen edhe shpetimin tone.

Fron i ndrícim i Zotit Krisht gezohu, Zonj' e Shenjte, shtemb' e mannes drit' e arte, llambadhe e pashuar dhe e qëllshime, mburrje virgjero-re, bukurí e nénave Shen Marí gezohu.

Shpetona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortese qe nukë tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

IX. Qelli u-çudít edhe u-mahnít, edhe anet e



dheut u-shtankne krejt, se Zoti Krisht, si njeri u-çfaq per né truperisht, dhe u-tregua fáqeza, gjiri yt m' i gjere se qell' i math. Pra ty o Virgjereshe, me Engjej dhe me njerës, te madheshtojme o Hyjlíndese.

Ku gjetke te perikenj une s' e di, ku te futem i mjeri i várferi, ku te shpetónj, ku te gjenj perikje dhe ngushellím, ku ta kerkónj perkráhesin, ku te gjenj nje ndihme ne hidherím? Me ty vetem kam shprese, me ty vetem po mburrem, dhe prane teje po kerkónj shpetím.

Per mua s' esht e mundur t' i nemerónj, madheshtite qe ke o Hyjlíndese; je si nje det, pa kufí pa funt e plot me çudí, qe kapercejne çdo mejtím, se ke ndritur per besniket e tu, te cilet te nderojne, me mall edhe me bese, si Virgjereshe dhe Hyjlíndese.

Me hymne mirenjóhese lavderónj, dhe kendónj percellimin dhe hirin pa funt, edhe tregónj, forcen tende te pamatur kudó, dhe mireberjet pa kufí, qe ke derdhur permi mua si shi; pra i leçit me buje, me shpirt edhe me zemer, me mendje dhe me gjuhe gjithenjé.

Te fálurat e mia me hidherím, plot me lot e me qarje te mbýtura, prit-i me hir, edhe eja shpejt edhe me ndihmó, edhe kerkimet mi mbaró, se e ke ne dore posa ti je, Nen' e Kryezotit, pra bej nje shenje vetem, dhe me shpetó prej pshercítmeve.

Shpetona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Vir-

gjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortese qe nuke tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

*Dhe menjehere thuhet:*

Ti je e nderuar mi Kerubím, dhe e lavdruar pa perqasje mi Serafím; ti me te vertete linde Fjale Perendine; pra ty te madheshtojme, Zonje Hyjlíndese.

*Prifti e temjanís Alltarin dhe pópullin, ose shtepine, ku behet lutja, dhe ne keté mes, kendoheh Madheshtimet pasónjese:*

Ti je mé e larta mi qell e dhé, edhe ndrit mé teper, se çdo díell a hen' e yll, dhe ti na shpetove, te gjithë prej mallkimit, o Zonj' e tere botes, ty te kendojme sot.

Barra e mekátave me dermón, m' u-semúr pra trupi, edhe shpirti m' u-err ne Ferr; me ty pra perikenj, Hyjlíndese hirplote, o shpres' e deshperimit, ti me shpetó taní.

Nen' e Shpetimtarit o Shen Marí, prit-i lutjet tona, te pavýera dhempsherisht, lutju pa pushuar, atí qe e ke lindur, o Zonj' e tere botes, ti nermjetó per né.

Kengen ta kendojme plot me gezím, ty moj e bekuar, Virgjereshe Zonje Marí. Tok me Shen Joanin, edhe gjithë Shenjtoret, o Zonje lutju Krishtit, te meshiróhemi.

Gojet e pabesa u-thafshin krejt, qe nuk adhu-

rojne, koren tende besnikerisht, qe na u-tregua, prej nje historiani, Luka Shen Apostullit, si udhheqese.

Forca Engjellore mi qell e dhe, o Joán i Shenjte, Dymbedhjetë Shen Apostúj, të gjithë Shenjtorët, me Zonjen Virgjereshe, të gjithë nermjetoni, qe të shpëtohemi.

*Pastáj thuhet Trishenjtí:*

KENDONJESI: Shenjt Perëndí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*3 here*).

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte, taní dhe perherë dhe në jetet e jeteve, Amín.

Triní e Tërshenjte, meshirona; o Zot, hircsoji mekakat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte veshtroji, dhe sheroji semundjet tona për emrin tënt. Meshiró, o Zot (*3 here*).

Ati yne, qe je në qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbretëria jote; u-befte deshira jote si në qell edhe mi dhe; buken tone të perdicime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe në ua falim fajtove tane; edhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja është Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte, taní dhe perherë dhe në jetet e jeteve.

KORI: Amín.

*Pastáj thuhet Troparet pasónjese me T. T. II:*

Kij meshire për në o Zot, kij meshire për në, se nukë kemi tjetër mprojtje, dhe perandáj në me-

kataret, perunjesisht po të lútemi: Kij meshire për në o Zot.

LAVDI. Kij meshire për në o Zot, se ty të kemi patur besím; mos kij merí kunder neve, mos i kujtó paudhesite tona, po shikona si meshireplót dhe shpëtona prej armiqve tane, se ti je Perendia yne, dhe në jemi pópulli yt, edhe veprat e dúarve të tua, dhe po thërresim emrin tënt.

TANI. Çelna derën e meshires sate, o Hyjlíndese e bekuar, se me ty kemi shpresë; mos na neverít po shpëtona prej rezíkeve, se ti je shpëtím i të Krishtëve.

*Priifti kujtón perserí besniket, për të cilet behet lutja:*

PRIFTI: Meshirona, o Perëndí, pas meshires sate se madhe, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Lútemi edhe për shëndetin, për shpëtimin edhe për ndjesën e mekátave të shërbetóreve të Perendisë (*aksh*).

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

RIFTI: Se ti je Perëndí meshireplót edhe njeridashes, dhe ty të dergojme lavdí, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte, taní dhe perherë dhe në jetet e jeteve.

KORI: Amín.

*Pastáj Priifti thote Perleshimin e Shkurter:*

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të

Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jeteve,  
Amín. Meshiró, o Zot (*3 here*). Bekó, o Ate.

PRIFTI: Krishti Perendia yne i vertete, me  
nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithe Shenj-  
tóreve, na meshirofte, dhe na shpetofte si i mire  
dhe njeridashes.

KORI: Amín.

*Pastáj Vellézerit pershendoshin koren e Shen Marise,  
dhe ne keté mes kendohen Dergimesoret pasónjese ne  
T. III:*

#### APOSTOLI EK PERATON

O Apostúj qe u-mblohte, ketú nga anet e  
dheut, ne fshat te Gjethsemanise, kufomen ju  
ma varrosni; dhe ti o Bir merma shpirtin, qe tok  
te jemi per jete.

O embelsí engjellore, dhe ngazellím per te mje-  
ret, ti qe i mpron te Krishteret, o Shen Marí Vir-  
gjereshë; perkrah-me ti dhe shpetome, nga  
zjarr' i Ferrit per jete.

O nermjetare e vetem, per Perendine lart ne  
qell, mos me denó per mekatat, ne gjykatoren e  
larte, te lutem pra Virgjereshe, eja shpetome  
prej Ferrit.

Ti o keshtjéll' e florinjte, me dymbedhjete for-  
tesa, o fron qe ndrit si díelli, ku rri Jesúj si Mbret  
i Math. Ti o çudí qe s' ke kufí, si mban ne gji  
Kryezotin.